FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 105

Tiranë – E premte, 15 korrik 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 59/2022, datë 7.7.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021, "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar	13055
Vendim i Kuvendit nr. 60/2022, datë 7.7.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 13/2022, "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar	13055
Rezolutë e Kuvendit datë 7.7.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2021	13055
Rezolutë e Kuvendit datë 7.7.2022	Për përkujtimin dhe nderimin e viktimave të gjenocidit në Srebrenicë	13057
Rezolutë e Kuvendit datë 7.7.2022	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2021	13058
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 475, datë 13.7.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar	13060
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 476, datë 13.7.2022	Për miratimin e kalimit të pasurive nr. 68/121/1, nr. 68/137/2 dhe nr. 5212/7/1, me sipërfaqe, përkatësisht 5532 m^2, 2649 m^2 dhe 593 m^2, të ndodhura në zonën kadastrale 1739, nga pronë shtetërore, në pronë private, për shoqërinë *"Green Coast"* sh.p.k., dhe miratimin e projektkontratës që do të lidhet për këtë qëllim, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe shoqërisë *"Green Coast"* sh.p.k.	13062
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 477, datë 13.7.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 501, datë 29.8.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për ekspertët e objekteve të pronësisë industriale"	13067

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 478, datë 13.7.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 906, datë 18.11.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës shtetërore, me numra pasurie 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, pjesë e zonës kadastrale nr. 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën e ish-Kënetës, Spitallë".....	13067
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 479, datë 13.7.2022	Për përcaktimin e rregullave të publicitetit të pajisjeve mjekësore që tregtohen në Republikën e Shqipërisë.....	13068
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 13.7.2022	Për miratimin e dhënies së granteve për *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve.....	13070
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 482, datë 13.7.2022	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe *Artigiancassa S.P.A.*, për financimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare, ratifikuar me ligjin nr. 147/2013.....	13071
Urdhër i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 240/1, datë 4.7.2022	Për caktimin e tarifave për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave.....	13073
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 31, datë 6.7.2022	Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga OTP Bank Nyrt (Hungari) të 100 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Alpha Albania sha.....	13074
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 33, datë 6.7.2022	Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren "Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISAR)".	13075
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 34, datë 6.7.2022	Për dhënien e miratimit paraprak për rritjen e përqindjes së pjesëmarrjes influencuese të aksionarit "EUROSIG" sh.a. në kapitalin e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a	13078

VENDIM
Nr. 59/2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 69/2021, "PËR CAKTIMIN E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, neneve 21, pika 2, dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në vendimin e Kuvendit nr. 69/2021, "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

"Deputeti Pandeli Majko caktohet anëtar në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriu dhe anëtar zëvendësues në Komisionin për Politikën e Jashtme.".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 7.7.2022.

VENDIM
Nr. 60/2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 13/2022, "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË POSAÇËM PËR REFORMËN ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 77, pika 1, e 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 24 e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit të Posaçme Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën Shqipërisë.

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Në pikën V të vendimit të Kuvendit nr. 13/2022, "Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Administrativo-Territoriale në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, fjalia e parë ndryshon, si më poshtë:

"Komisioni do të zhvillojë veprimtarinë e tij deri më 30 shtator 2022.".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 7.7.2022.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar rolin e institucionit për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e fondeve publike;

Duke vlerësuar rëndësinë e funksionimit të këtij institucioni mbi bazë të garantimit të parimeve të pavarësisë, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, interesit të publikut, profesionalizmit, bashkëpunimit dhe transparencës;

Duke mbështetur dhe nxitur Kontrollin e Lartë të Shtetit për të punuar dhe kontribuar për një qeverisje të mirë nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike, rritjes së besimit të publikut dhe nxitjes së përdorimit me ekonomicitet, eficiencë dhe efikasitet të fondeve publike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikat më të mira të BE-së e standardeve ndërkombëtare INTOSAI,

Vlerëson veprimtarinë e KLSH-së për vitin 2021, në drejtim të:

Angazhimit për kryerjen e auditimeve në pajtueshmëri me standardet dhe praktikat ndërkombëtare të auditimit, duke bërë të mundur përfundimin dhe evadimin e 158 auditimeve të ushtruara në 205 subjekte në nivel vendor dhe qendror.

Adresimit të një numri total prej 4251 rekomandimesh për institucionet publike të audituara, nga të cilat 90 rekomandime për përmirësime ligjore, 3074 rekomandime organizative, 912 rekomandime disiplinore dhe 175 administrative.

Vijimit të punës për rritjen e dobisë së rezultateve të auditimit, duke zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare në fushën e menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, administrimin e pronës shtetërore dhe prokurimin publik.

Intensifikimin e veprimtarisë së zbulimit dhe ndëshkimit të korrupsionit, duke paraqitur pranë organit të prokurorisë 14 kallëzime dhe indicie penale për 62 zyrtarë të niveleve të ndryshme, prej të cilëve 24 kanë mbajtur pozicione drejtuese dhe 2 të tjerë kanë qenë ish-nënkryetarë të bashkive Tropojë dhe Kurbin.

Angazhimit maksimal në të qenët aktiv dhe produktiv në luftën kundër korrupsionit, duke përkrahur, mbështetur dhe angazhuar çdo iniciativë ndërinstitucionale brenda dhe jashtë vendit, si dhe në ndjekjen e 111 proceseve gjyqësore, nga të cilat 12 procese gjyqësore të karakterit penal, 98 procese gjyqësore të karakterit administrativ dhe/ose civil dhe 1 proces në Gjykatën Kushtetuese.

Rritjes së besueshmërisë së publikut nëpërmjet trajtimit të 399 letrave dhe ankesave, nga të cilat pjesa kryesore u adresohet problematikave, që lidhen me privatizimin dhe kthimin e pronës.

Modernizimit të aktivitetit audites dhe trajnimin e audituesve të KLSH-së, të cilët në fund të vitit 2020 rezulton se kanë siguruar një mesatare prej 27.2 ditësh trajnimi/audites nëpërmjet realizimit të 3059 ditë trajnimi në total.

Kuvendi kërkon që KLSH-ja për vitin 2022 të vazhdojë punën në këto drejtime:

1. Të fokusohet në auditime sistemi, duke riklasifikuar fushat audituese, duke marrë në konsideratë edhe kritere të tjera, si prioritetet qeverisëse dhe ato subjekte që mbajnë peshën sektoriale buxhetore.

2. Të rrisë impaktin e auditimit nëpërmjet përmirësimit të qasjeve dhe cilësisë së raporteve, si produkt i punës audituese, duke synuar nxitjen e ndryshimeve pozitive dhe përmirësimeve në drejtim të promovimit të qeverisjes së mirë në vend.

3. Të nxisë mbikëqyrjen publike dhe të rrisë cilësinë, transparencën dhe parandalimin e korrupsionit në ofertat publike, koncesionet dhe partneritetet publike-private (PPP) nëpërmjet zhvillimit të auditimeve më cilësore, si dhe dhënien e rekomandimeve me vlerë të shtuar në mirëmenaxhimin e kontratave të PPP-ve, duke përmirësuar edhe kuadrin ligjor të realizimit të tenderave publikë përkatës dhe të lidhjes dhe zbatimit të kontratave koncesionare.

4. Në funksion të rritjes së shkallës së zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së të forcojë bashkëpunimin me ekzekutivin dhe legjislativin nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të ndërtuara në bashkëpunim me këto institucione dhe të ketë një qasje bashkëpunuese me Ministrinë e Financave për kategorinë e rekomandimeve që paraqesin detyrime financiare shtesë në buxhetin e shtetit.

5. Të publikojë raportet e auditimit në faqen web brenda 60 ditëve nga protokollimi i vendimit të Auditimit, si dhe të angazhohet në pasurimin e Platformës Ndërinstitucionale *Online* me hedhjen e të dhënave, sipas përcaktimeve në vendimin e Kuvendit nr. 49/2017, "Për krijimin e mekanizmit të monitorimit sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj".

6. Të përmirësojë treguesit e transparencës përmes komunikimit të rezultateve të KLSH-së për Kuvendin, publikun dhe palët e interesit, si dhe duke rritur nivelin e publikimeve të raporteve të auditimit në faqen zyrtare.

7. Të modernizojë kanalet e komunikimit për të forcuar mesazhet kyçe në qasje të çdo pale të interesit, duke aplikuar metoda e rrugë inovative, duke theksuar rëndësinë e komunikimit efektiv midis KLSH-së e publikut dhe rritjes së transparencës, si dhe të krijojë një hapësirë të dedikuar në faqen zyrtare për komunikim me publikun dhe institucionet.

8. Të angazhohet për optimizimin e kapaciteteve profesionale, aftësive audituese,

procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse si prioritete kryesore në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore.

9. Të intensifikojë bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare për përditësimin e vazhdueshëm të metodologjive të auditimit dhe aplikimin e praktikave më të mira në frymën e zbatimit të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të institucionit.

10. Të bashkëpunojë në mënyrë të vazhdueshme me faktorët kyç vendimmarrës në luftën kundër korrupsionit dhe vënies përpara përgjegjësisë të nëpunësve të lartë të shtetit, abuzues me interesin publik.

Miratuar në datën 7.7.2022.

REZOLUTË

PËR PËRKUJTIMIN DHE NDERIMIN E VIKTIMAVE TË GJENOCIDIT NË SREBRENICË

Duke mbajtur parasysh Kartën e Kombeve të Bashkuara, Konventat e Gjenevës dhe protokollet shtesë, Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, Statutin e Romës, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Aktin Final të Helsinkit, Paktin për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Evropiane dhe dokumentet e tjera të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë dhe të Bashkimit Evropian për të drejtat e njeriut;

Duke iu referuar Aktgjykimit të Apelit, rasti nr. IT-99-33, 19 prill 1993 nga Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë, ku masakra në Srebrenicë është njohur dhe pranuar si gjenocid; vendimit të apelit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë 26 shkurt 2007, që konstaton se aktet e kryera në Srebrenicë dhe rrethinë rreth datës 15 korrik 1995 janë akte të gjenocidit dhe se të njëjtat duhet të quhen me emrin e vërtetë: gjenocid; Aktgjykimit të Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë në rastin nr. IT-09-92-T, 22 nëntor 2017 dhe vendimit të Apelit të Mekanizmit të Përhershëm Ndërkombëtar për Gjykatat Penale për rastin MICT-13-56-A, 8 qershor 2021;

Bazuar në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 827 të datës 25 maj 1993, 1551 të datës 9 korrik 2004 dhe 1575 të datës 22 nëntor 2004;

Në përputhje të plotë me rezolutat e Parlamentit Evropian të datave 7 korrik 2005, 15 janar 2009 dhe 15 korrik 2015 për përkujtimin e gjenocidit në Srebrenicë, si dhe me vlerësimet e raportit të Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës të Këshillit të Evropës, ECRI, miratuar më 22 mars 2017;

I njëzëshëm me deklaratat e përfaqësuesit të lartë të Bashkimit Evropian për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë e njëkohësisht zëvendëspresident i Komisionit Evropian, zotit Josep Borrell, si dhe të Komisionerit Olivér Várhelyi për gjenocidin në Srebrenicë;

Në mbështetje dhe në zbatim të përparësive të Republikës së Shqipërisë të përcaktuara për mandatin në Këshillin e Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për periudhën 2022–2023, si dhe programit të punës së Presidencës Shqiptare të Këshillit të Sigurimit për muajin qershor 2022, që ka në qendër respektimin e të drejtës ndërkombëtare dhe forcimin e llogaridhënies për shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare dhe në frymën e debatit të hapur të nivelit të lartë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së "Për forcimin e llogaridhënies dhe drejtësisë për shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare", të zhvilluar në datën 2 qershor 2022;

Me vullnetin e palëkundur për të kontribuar në ruajtjen dhe forcimin e paqes, sigurisë dhe vlerave demokratike në Evropë, e veçanërisht në rajonin e Ballkanit Perëndimor,

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë:

Konfirmon qëndrimin e Shqipërisë se mohimi i gjenocidit të kryer ndaj popullatës boshnjake në Srebrenicë nga forcat serbe të Bosnjës përbën shkelje të ligjit ndërkombëtar, nxit fenomenin e pandëshkueshmërisë ndaj krimeve të luftës, si dhe shkel mbi dinjitetin e më shumë se 8 mijë civilëve që u masakruan në Srebrenicë, të mbijetuarave dhe familjeve të tyre, por edhe ndaj rreth 10 mijë shqiptarëve të vrarë gjatë spastrimit etnik në Kosovë dhe 20 mijë grave të dhunuara nga regjimi serb i Slobodan Milosheviçit.

Shpreh dhimbjen e thellë për viktimat dhe traumat njerëzore të shkaktuara nga gjenocidi në Srebrenicë, si dhe mirëkuptimin e plotë dhe

simpatinë e sinqertë ndaj tërë të lënduarve gjatë luftës së përgjakshme në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Dënon fuqimisht çdo prirje dhe veprim për të mohuar publikisht, me qëllim ose jo gjenocidin e kryer në Srebrenicë, fshehjen e motiveve, lavdimin e autorëve, ideatorëve dhe mbështetësve të këtij gjenocidi, si dhe e konsideron të papranueshme e tejet të rrezikshme vazhdimin dhe përshkallëzimin e retorikës politike nacionaliste, nxitjen e urrejtjes etnike, si pasojë e mohimit të gjenocidit të kryer në Srebrenicë, masakrave dhe krimeve të tjera kundër njerëzimit kryer në të gjithë hapësirën e ish-Jugosllavisë nga disa individë, grupime e aktorë politikë e medietikë brenda e jashtë rajonit të Ballkanit.

Bashkohet me vlerësimin se qëndrimet e kandidatëve për anëtarësim në BE duhet të përputhen plotësisht jo vetëm me *acquis* të BE-së, por edhe me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së, në linjë me ato parime e vlera të vendosura nga Bashkimi Evropian dhe të gjitha vendet demokratike, sipas të cilave mohimi dhe mosdënimi publik i gjenocidit në Srebrenicë është i papajtueshëm me vlerat dhe aspiratat evropiane.

U bën thirrje të gjitha vendeve anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organeve ndërkombëtare e kombëtare të drejtësisë të rrisin angazhimin dhe përpjekjet e tyre serioze për ndjekjen penale dhe ndëshkimin e kriminelëve të luftës dhe bashkëpunëtorëve të tyre përgjegjës për gjenocidin dhe krimet e tjera të luftës.

U bën thirrje Bashkimit Evropian, NATO-s dhe secilit prej vendeve të tyre anëtare, të punojnë me intensitet për të përshpejtuar proceset e zgjerimit, si një garanci për konsolidimin e vlerave demokratike, paqes dhe sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Evropë e më gjerë.

Shpreh mbështetjen e plotë për qëndrimet, veprimet dhe masat e marra nga qeveria shqiptare në mbështetje të parimeve mbi të cilat është ndërtuar siguria evropiane dhe rendi global i marrëdhënieve midis shteteve.

Duke vlerësuar dhe përkrahur angazhimin serioz, profesional e në frymë të lartë përgjegjësie të qeverisë shqiptare në përmbushje të rolit të Shqipërisë si anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për periudhën 2022–2023, i kërkon qeverisë, që:

Të vazhdojë angazhimin e saj në mbrojtje të parimeve dhe normave të së drejtës ndërkombëtare dhe forcimin e llogaridhënies për shkeljet e rënda të saj, në bashkërendim të ngushtë me të gjitha vendet aleate dhe partnere të Këshillit të Sigurimit, BE-së, OSBE-së dhe Këshillit të Evropës.

Të nderojë viktimat e gjenocidit në Srebrenicë dhe, duke iu referuar vendimit të Parlamentit Evropian, të shpallë datën 11 korrik si Ditën e Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë.

Të japë tërë kontributin e saj në mbështetje të thellimit të reformave dhe proceseve demokratike për konsolidimin e një shoqërie ku sundon ligji, drejtësia dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor, fryma e bashkëpunimit rajonal, fqinjësisë së mirë dhe integrimit evropian, si rruga e vetme për të kapërcyer urrejtjen dhe ndarjet, për të promovuar drejtësinë mbi bazën e së cilës ndërtohet paqja, siguria dhe pajtimi mes popujve në rajon, Evropë e më gjerë.

Të punojë pareshtuar për forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, në frymën e respektit reciprok, parimeve të barazisë, frymës së pajtimit dhe mirëkuptimit për të ndërtuar një të ardhme të përbashkët të drejtë, duke forcuar lidhjet politike, ekonomike dhe tregtare mes vendeve, si dhe kontaktet mes njerëzve, në të mirë të paqes, sigurisë, përparimit ekonomik e shoqëror për çdo vend dhe rajonin në tërësi.

Miratuar në datën 7.7.2022.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke konsideruar Komisionin e Prokurimit Publik si organin më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm për KPP-në paanësinë në vendimmarrje, transparencën, efikasitetin dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e interesit publik përmes një administrate të përgjegjshme, e cila mirëmenaxhon fondet publike, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të

operatorëve ekonomikë nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve kontraktore;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm rolin që KPP-ja ka në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik;

Duke vlerësuar si një arritje tepër të rëndësishme implementimin e reformës së digjitalizimit të shërbimeve dhe menaxhimit të ankesave, me ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës dhe minimizimin e korrupsionit;

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2021 dhe vlerëson:

Punën e bërë për finalizimin me sukses të projektit të digjitalizimit si një hap i rëndësishëm për një institucion më transparent, më të hapur dhe që mundëson akses të plotë për të gjithë operatorët ekonomikë, vendas dhe të huaj, të dorëzojnë elektronikisht ankesat dhe argumentet e tyre si dy shërbime të veçuara, duke zeruar kostot ekstra dhe kontaktin e drejtpërdrejtë me çdo zyrë shteti, përfshirë edhe vetë Komisionin e Prokurimit Publik.

Përpjekjet për uljen e numrit të ankesave të shqyrtuara jashtë afatit dhe rritjen e shpejtësisë së kohës së vendimmarrjes gjatë vitit 2021 krahasuar me një vit më parë, duke përgjysmuar numrin e ankesave të shqyrtuara jashtë afatit krahasuar me një vit më parë.

Masat e marra në kuadër të transparencës ndaj qytetarëve për pasqyrimin në faqen zyrtare jo vetëm të vendimeve të marra gjatë vitit 2020, por edhe të vendimeve të marra gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019. Faqja e re e KPP-së në internet mundëson tanimë akses në tre regjistra publikë: atë të ankesave, vendimeve dhe historikut të vendimeve. Njëkohësisht faqja e re mundëson akses për personat me probleme në shikim (verbëri, verbëri ngjyrash dhe shikim të dobët) nëpërmjet një motori të veçantë aksesi.

Punën e bërë për vendosjen e praktikave të konsoliduara për trajtimin e çështjeve të reja për këtë institucion lidhur me ndryshimet thelbësore materiale dhe procedurale që ka sjellë hyrja në fuqi e ligjit të ri në procesin e shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimit publik.

Punën e bërë për hartimin dhe miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e institucionit, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit të ri të prokurimit publik.

Bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës dhe Gjykatën Administrative të Apelit për trajnimin e punonjësve të të dyja institucioneve, me qëllim aftësimin e tyre në trajtimin e çështjeve komplekse të prokurimit publik.

Bashkëpunimin me Universitetin e Tiranës për hartimin e një kurrikule të posaçme trajnimi për zyrtarët e KPP-së, në saje të të cilit është bërë i mundur trajnimi i punonjësve nga pedagogët e tri fakulteteve kryesore në vend, përkatësisht: Fakultetit Juridik, Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Gjuhëve të Huaja.

Miratimin e disa vendimeve interpretuese lidhur me çështje specifike me rëndësi për sistemin, me synim shmangien e përsëritjes së problematikave të konstatuara.

Me gjithë përmirësimet e bëra kemi akoma një numër ankesash të cilat janë shqyrtuar jashtë afateve ligjore.

Numri i ankesave të mospranuara për shkaqe të mosplotësimit të kritereve formale është relativisht i lartë.

Operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore duhet të jenë më të informuar lidhur me ndryshimet në legjislacionin e prokurimit publik.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 kërkon që Komisioni i Prokurimit Publik të angazhohet veçanërisht në këto aspekte të veprimtarisë së tij:

1. Të investohet me kapacitet të plotë për uljen e numrit të ankesave të shqyrtuara jashtë afateve ligjore, duke ndjekur trendin përmirësues të vitit 2021.

2. Të punojë për plotësimin e vendeve vakante, duke rekrutuar profesionistë të kualifikuar të fushës, si një faktor i cili ndikon drejtpërdrejt në rritjen e efikasitetit dhe cilësinë e vendimmarrjes së KPP-së dhe në të njëjtën kohë të vijojë punën për trajnimin e punonjësve të Komisionit të Prokurimit Publik, me qëllim rritjen dhe forcimin e kapaciteteve profesionale në vazhdimësi.

3. Të angazhohet në vazhdimësi për informimin e operatorëve ekonomikë dhe autoriteteve kontraktore përmes organizimit të tryezave/ fushatave informuese, si dhe të hartojë kurrikulat e trajnimit për zyrtarët e prokurimit, komisionin e vlerësimit të ofertave, me qëllim uljen e numrit të ankesave të mospranuara për shkaqe të mosplotësimit të kritereve formale, si dhe të

ndikojë në përmirësimin e cilësisë së punës nga ana e autoriteteve kontraktore.

4. Të rrisë përpjekjet për ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë për përdorimin e sistemit të ri të dorëzimit të ankesave *online* nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania,* si dhe të miratojë manualet e përdorimit të Sistemit të Ankesave Elektronike për operatorët ekonomikë dhe autoritetet kontraktore.

5. Të bashkëpunojë ngushtësisht me Agjencinë e Prokurimit Publik për të bërë të mundur krijimin e standardeve të njëjta në trajtimin e çështjeve të ngjashme dhe njëkohësisht marrjen në konsideratë nga APP-ja të problematikave të ankesave, duke krijuar kështu një model pune.

6. KPP-ja në vijim të procesit të digjitalizimit të punojë për implementimin e fazës së dytë për integrimin e proceseve të brendshme administrative në sistemin e dorëzimit dhe shqyrtimit të ankesave (sistemi ERP).

7. Të vijojë monitorimin e zbatimit të vendimeve të Komisionit të Prokurimit Publik, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve të administratës shtetërore, në lidhje me detyrimin për të zbatuar vendimet e KPP-së në kohë, si një detyrim që lidhet drejtpërdrejt me një proces të rregullt ligjor për palët në proces dhe që mbron interesin publik.

8. Të rrisë bashkëpunimin me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës për krijimin e kurrikulave të përbashkëta të trajnimit, magjistratë dhe zyrtarë prokurimi.

Miratuar në datën 7.7.2022.

VENDIM
Nr. 475, datë 13.7.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1/3 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

i. Në shkronjën "a" shtohet emërtesa "Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor";

ii. Në shkronjën "b", emërtesa "Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor" shfuqizohet.

b) Pika 10/1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"10/1. Nivelet e pagave të punonjësve të trupës artistike në Teatrin Kombëtar, Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar të Komedisë dhe Cirkun Kombëtar janë sipas lidhjes nr. 7/1 (pjesët I, II, III dhe IV),

që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Vjetërsia në punë për punonjësit, që paguhen sipas lidhjes nr. 7/1, jepet në masën 2% pas çdo viti pune deri në 25 vjet dhe llogaritet mbi vlerën 14 000 (katërmbëdhjetë mijë) lekë.".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2022, përballohen nga fondet e miratuara në ligjin nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, për politikat e reja të pagave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2022.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Lidhja nr. 7/1

I. Për Teatrin Kombëtar

Nr.	Pozicioni	Paga (lekë)
1	Regjisor. Aktor i parë.	84.750
2	Asistent regjisor. Aktor i dytë.	75.950
3	Skenograf i kategorisë së parë.	64.000
4	Aktor i tretë.	62.400
5	Skenograf i kategorisë së dytë.	53.000

II. Për Drejtorinë e Operës dhe Filarmonisë dhe Drejtorinë e Baletit, në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor

Nr.	Pozicioni	Paga (lekë)
1	Drejtor Artistik i Operës dhe Filarmonisë. Dirigjent i Operës dhe Filarmonisë. Dirigjent (orkestre). Dirigjent (baleti). Solist i parë (lirik, baleti). Koncertmaestër. Baletmaestër. Dirigjent kori.	141.500
2	Spala sektori (orkestre).	134.600
3	Solist II (lirik, baleti, pianist). Spalë sektori (kori).	128.600
4	Asistent dirigjent. Orkestrant i kategorisë së parë.	123.900
5	Orkestrant i kategorisë së dytë.	118.600
6	Solist i tretë (lirik, baleti).	106.800
7	Korist i kategorisë së parë. Balerin i kategorisë së parë. Pianist korepetitor.	100.000
8	Korist i kategorisë së dytë. Pianist përgatitor. Balerin i kategorisë së dytë.	96.800

III. Për trupën artistike të Teatrit të Kukullave, në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, Teatrin Kombëtar të Komedisë dhe Cirkun Kombëtar

Nr.	Pozicioni	Paga (lekë)
1	Dirigjent. Regjisor. Drejtues artistik.	75.950
2	Skenograf i kategorisë së parë. Mjeshtër i studios së cirkut. Mjeshtër profili i numrave të cirkut. Aktor i parë. Akrobat i kategorisë së parë.	64.000
3	Aktor i dytë. Skenograf i kategorisë së dytë. Akrobat i kategorisë së dytë.	53.000

IV. Për Drejtorinë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore, në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor

Nr.	Pozicioni	Paga (lekë)
1	Drejtor i Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore. Mjeshtër vallesh (korepetitor).	123.900
2	Solist i parë. Orkestrant i kategorisë së parë. Korist i kategorisë së parë. Valltar i kategorisë së parë.	100.000
3	Orkestrant i kategorisë së dytë. Valltar i kategorisë së dytë. Korist i kategorisë së dytë.	95.700
4	Solist i dytë. Orkestrant i kategorisë së tretë. Valltar i kategorisë së tretë. Korist i kategorisë së tretë.	78.000

VENDIM
Nr. 476, datë 13.7.2022

PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PASURIVE NR. 68/121/1, NR. 68/137/2 DHE NR. 5212/7/1, ME SIPËRFAQE, PËRKATËSISHT 5532 m², 2649 m² DHE 593 m², TË NDODHURA NË ZONËN KADASTRALE 1739, NGA PRONË SHTETËRORE, NË PRONË PRIVATE, PËR SHOQËRINË "*GREEN COAST*" SHPK, DHE MIRATIMIN E PROJEKTKONTRATËS QË DO TË LIDHET PËR KËTË QËLLIM, NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË DHE SHOQËRISË "*GREEN COAST*" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 2, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve", miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, të ndryshuar, dhe në vijim, të pikës 7, të vendimit nr. 807, datë 11.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve dhe të kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit të pasurive nr. 68/121/1, nr. 68/137/2 dhe nr. 5212/7/1, me sipërfaqe, përkatësisht 5532 m², 2649 m² dhe 593 m², të ndodhura në Palasë, Himarë, zona kadastrale 1739, nga pronë shtetërore, në pronë private, për shoqërinë "*Green Coast*", sh.p.k., në funksion të planit të përgjithshëm vendor, sipas planrilevimit,

bashkëlidhur këtij vendimi, me kushtin e realizimit të projektit, si dhe të marrëveshjes *Franchise*, të lidhur midis palëve "*Green Coast*" sh.p.k., dhe "*ACCOR SERVICES POLAND SP ZOO*".

2. Miratimin e projektkontratës, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si shitës, dhe shoqërisë "*Green Coast*", sh.p.k., si blerës, për pasuritë shtetërore nr. 68/121/1, me sipërfaqe 5532 m^2, nr. 68/137/2, me sipërfaqe 2649 m^2, dhe nr. 5212/7/1, me sipërfaqe 593 m^2, të cilat ndodhen në Palasë, Himarë, zona kadastrale 1739, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË

NR. _____ REP.

NR._____ KOL.

KONTRATË SHITJE ME KUSHT PËR KALIMIN E PRONËS SHTETËRORE NË PRONË PRIVATE NË FAVOR TË SHOQËRISË "Green Coast" sh.p.k.

Lidhur sot, më datë ____.____.2022 (dymijë e njëzetë e dy), përpara meje, noterit _____, me seli në Tiranë, u paraqitën personalisht dhe më kërkuan hartimin e kësaj kontrate për kalimin e pronës shtetërore (truall) në pronë private palët si më poshtë:

Neni 1 – Palët

Pala shitëse: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, Tiranë, përfaqësuar nga **z.** _____, lindur në _____, me detyrë drejtor, i identifikuar me anë të nr. personal _____.

Pala blerëse: Shoqëria "**Green Coast**" sh.p.k. me NUIS _____ me seli në Tiranë, Rruga e _____, e përfaqësuar nga administratori z. Latif Drenofci lindur me _____ në _____, banues në _____, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar me anë të letërnjoftimit nr. personal _____.

Neni 2 – Objekti i kontratës

Objekt i kësaj kontratë është shitja me kushtet sipas përcaktimeve në nenin 4, pika 4.3, e pronës shtetërore (truall) në funksion të planeve të përgjithshme vendore (leje zhvillimore) me sipërfaqe 8774 m^2. Prona shtetërore (truall) ndodhet në Palasë, Himarë, në zonën kadastrale 1739, prek pasuritë nr. 68/121/1 me sipërfaqe 5532 m^2, nr. 68/137/2 me sipërfaqe 2649 m^2 dhe nr. 5212/7/1 me sipërfaqe 593 m^2.

Këto pasuri shtetërore kufizohen sipas hartës treguese bashkëlidhur kësaj kontrate.

Neni 3 – Çmimi i shitjes

3.1 Çmimi i shitjes së pasurisë shtetërore që kalon në pronë private është **18 732 490 (tetëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë**. Kjo vlerë është paguar plotësisht nga pala blerëse për llogari të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike Tiranë në llogarinë të "ardhura nga shitja-tokë, troje, terrene" me nr. 1161110, sipas kushteve të vendosura në Autorizimin për kryerje pagese nr. _____ prot., datë _____.2022.

3.2 Pala shitëse deklaron se në favor të saj është derdhur e gjithë shuma e përcaktuar në pikën 3.1. të këtij neni, para kohës së përpilimit të kësaj kontrate sipas mandatarkëtimit/njoftim Debitimi, datë _____.2022 pranë _____ Bank.

Neni 4 – Kushtet e shitjes

4.1 Pala blerëse ka plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara nga pala shitëse në autorizimin për kryerje pagese nr. _____ prot., datë ____.2022.

4.2 Blerësi gjykohet se ka njohuri të plota për pasurinë pronë shtetërore, e cila ndodhet në Palasë, Himarë, që kalon në pronë private dhe nuk ka asnjë pretendim lidhur me të.

4.3 Momenti i kalimit të pronësisë së pronës shtetërore, në pronë private do të lidhet me realizimin e projektit, në funksion të të cilit është kërkuar kalimi i pronës shtetërorë në pronë private (zhvillimi i projektit në përputhje me lejen zhvillimore, si dhe zbatimi i kushtit të KIS për

ndërtimin e hotelit të standardit pesë yje dhe Marrëveshjes Franchise të lidhur midis palëve "GREEN COAST" sh.p.k. dhe "ACCOR SERVICES POLAND SP ZOO"). Kontrata, pas nënshkrimit të saj, regjistrohet në zyrën përkatëse të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me shënimin përkatës.

4.4 Nëse miratimi i lejes për zhvillimin e projektit, në funksion të të cilit është kërkuar kalimi i pronës shtetërorë në pronë private, nuk bëhet brenda 5 (pesë) vjetëve nga nënshkrimi i kontratës, atëherë kontrata zgjidhet dhe palët i kthejnë njëra-tjetrës çdo gjë që i kanë dhënë si pasojë e kësaj kontrate.

4.5 Çmimi i përfituar nga kalimi i sipërfaqeve të pronës shtetërore në pronë private, sipas këtij vendimi, kalon 100 për qind në buxhetin e shtetit.

Neni 5 – Detyrimet e shitësit

5.1 Shitësi garanton se prona që kalon në pronë private është pasuri shtetërore, fakt të cilin e vërteton i gjithë dokumentacioni që është i depozituar në dosjen përkatëse pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike.

Neni 6 – Të drejta dhe detyrime të blerësit

6.1 Blerësi ka pranuar kalimin e pronës shtetërore në pronë private sipas kushteve të përcaktuara në autorizimin për kryerje pagese nr. _____ prot., datë _____.2022.

6.2 Blerësit i kalon e drejta e pronësisë mbi pronën shtetërore, pasi të jetë plotësuar kushti i përcaktuar në pikën 4.3, të nenit 4. Me lidhjen dhe regjistrin e kësaj kontrate në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, blerësi ka të drejtë të kryejë çdo veprim të nevojshëm mbi pasurinë e paluajtshme, objekt të kësaj kontrate, për miratimin e lejes dhe zhvillimin e projektit në funksion të të cilit është kërkuar kalimi i pronës shtetërore në pronë private".

6.3 Blerësi merr përsipër për të paguar të gjitha shpenzimet për veprimet noteriale, si dhe çdo shpenzim tjetër që lidhet me këtë akt bazuar në nenin 708, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7 – Baza ligjore për lidhjen e kontratës

7.1 Neni 83, 705 i Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë. **Ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008** "Për miratimin e Aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave "Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve", i ndryshuar.

VKM nr. 807, datë 11.12.2019 "Për përcaktimin e kritereve dhe të kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshëm vendore.

Neni 8 – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje midis palëve për pikat e kësaj kontrate zgjidhet me mirëkuptim. Në rast të kundërt palët i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 9 – Pjesët përbërëse të kontratës

9.1 Pjesë e kësaj kontrate janë: autorizimi për kryerje pagese nr. _____ prot., datë _____.2022 lëshuar nga Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike Tiranë, kartelat e pasurisë së paluajtshme me HTR për sipërfaqen pronë shtetërore që kalon në pronë private, planvendosja e sipërfaqes pronë shtetërore (plan rilevimi), mandatpagesa e cituar në nenin 3, pika 3.2, të kësaj kontrate, Ekstrakti i Regjistrit Tregtar.

Neni 10 – Dispozita përfundimtare

10.1 Kjo kontratë është përpiluar në 4 (katër) kopje, me vlerë të njëjtë dhe përbëhet nga 3 (tri) faqe secila, ku një kopje qëndron pranë kësaj zyre noteriale, një kopje i jepet blerësit një kopje i dërgohet Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorisë Vendore Vlorë, një kopje i jepet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike.

10.2 Kontrata pasi lexohet nga palët, kuptohet përmbajtja e saj, është e njëjtë me vullnetin e tyre dhe nënshkruhet pa vërejtje para noterit.

10.3 Për sa më sipër, unë Noteri, pasi konstatova se akti i mësipërm është në pajtim të plotë me vullnetin e palëve dhe me ligjin e vërtetoj atë rregullisht.

Neni 11 – Regjistrimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

11.1 Regjistrimi i kësaj kontrate shitje në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtorinë Vendore Vlorë, do të bëhet nga blerësi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të saj. Në të kundërt për çdo ditë vonesë në bazë të ligjit nr. 111/2018, datë 7.2.2019, "Për kadastrën", detyrohet të paguajë një tarifë shtesë gjobe konform rregullave përkatëse.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA SHITËSE

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike

PALA BLERËS

Shoqëria "Green Coast" sh.p.k.
Administrator

_____

NOTERI

_____




36/6
5212/6
36/8/2
36/8/1
36/5
5227/3
5227/4
36/9
68/33
68/32
68/29
68/30
68/87/10
68/87/8
5227/2
68/87/9
68/87/13
68/87/14
68/87/1
68/87/15
68/87/11
68/87/12
68/87/6
68/87/5
68/88/3
68/88/2
68/86/3
68/88/4
68/109
68/109/4
68/109/5
68/89/5
68/89/4
68/104/1
68/104/2
68/104/3
68/103/3
68/103/4
68/104/4
68/101/4
68/90/2
68/90/4
68/90/5
68/91/4
68/101/3
68/101/5
68/100/4
68/100/3
68/102/4
68/102/3
68/102/2
68/106/2
68/99/4
68/140/2
68/106/1
68/140/12
68/140/15
68/140/5
68/140/8
68/140/3
68/140/10
68/115/2
68/115/1
68/115/7
68/115/8
68/115/12
68/115/13
68/115/11
68/115/10
68/115/9
68/115/6
68/114/3
68/114/4
68/121/2
68/137/1
68/137/2
68/121/1
68/140/13
68/140/14
Për Shoqërinë Green Coast
Administratori
Green Coast
L41329038D

VENDIM
Nr. 477, datë 13.7.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 501, DATË 29.8.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR EKSPERTËT E OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 198/b, 198/c, 198/ç dhe 202, të ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për pronësinë industriale", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kudo në tekstin e rregullores "Për ekspertët e objekteve të pronësisë industriale", miratuar me vendimin nr. 501, datë 29.8.2018, të Këshillit Ministrave, fjalët: "të licencohet", "licencim", "t'u licencuar", "licencimit", "licencën", "licencë", "licenca", "licencës" zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët "të certifikohet", "certifikim", "t'u certifikuar", "certifikimit", "certifikatën", "certifikatë", "certifikata", "certifikatës".

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 478, datë 13.7.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 906, DATË 18.11.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, TË PRONËS SHTETËRORE, ME NUMRA PASURIE 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, PJESË E ZONËS KADASTRALE NR. 8517, BASHKIA DURRËS, NJËSIA ADMINISTRATIVE DURRËS, NË ZONËN E ISH-KËNETËS, SPITALLË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 906, datë 18.11.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

2 a) Titulli ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës shtetërore, me numër pasurie 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, 63/2, 64/2, 65/2, 66/2, pjesë e zonës kadastrale 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën e ish-Kënetës, Spitallë.";

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të pronës shtetërore, me numër pasurie 46, 47, 48, 49, 50, 63, 64, 65, 66, 63/2, 64/2, 65/2, 66/2, pjesë e zonës kadastrale 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës, në zonën e ish-Kënetës, Spitallë, me vendndodhje dhe sipërfaqe, sipas aneksit I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.".

c) Aneksi I, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me aneksin I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

ANEKS I
Zona kadastrale 8517, Bashkia Durrës, Njësia Administrative Durrës

ZONIMI	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. ha
ZONA FOTOVOLTAIKE	8517	46	arë	14,25
	8517	47	arë	14,10
	8517	48	arë	14,00
	8517	49	arë	14,60
	8517	50	arë	13,50
	8517	63	arë	11,72
	8517	64	arë	12,72
	8517	65	arë	12,27
	8517	66	arë	12,35
	8517	63/2	arë	2,5
	8517	64/2	arë	2,8
	8517	65/2	arë	2,5
	8517	66/2	arë	2,5

VENDIM
Nr. 479, datë 13.7.2022

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË PUBLICITETIT TË PAJISJEVE MJEKËSORE QË TREGTOHEN NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 23/2, të ligjit nr. 89/2014, "Për pajisjet mjekësore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Vendimi ka për qëllim përcaktimin e rregullave të publicitetit të pajisjeve mjekësore, që tregtohen në Republikën e Shqipërisë.

2. Publiciteti i pajisjeve mjekësore, sipas këtij vendimi, nënkupton çdo aktivitet që promovon shitjen ose përdorimin e një pajisjeje mjekësore nga subjektet e përcaktuara në pikën 7, në çdo formë të shkruar ose verbalisht, duke përdorur foto dhe zë, në formë elektronike, digjitale ose të tjera.

3. Ndalohet publiciteti i çdo pajisjeje mjekësore, që nuk plotëson kushtet e përcaktuara, sipas legjislacionit në fuqi për pajisjet mjekësore dhe në këtë vendim, me përjashtim të pajisjeve mjekësore të destinuara për t'u përdorur në ekspozita, demonstrime, panaire ose në aktivitete të tjera të kësaj natyre. Pajisje të tilla duhet të sigurohen me një pamje të dukshme, të qartë, duke treguar se ato nuk mund të tregtohen ose të vihen në përdorim.

4. Publiciteti evidenton plotësimin e kritereve të pajisjes mjekësore për markimin CE ose certifikimin FDA.

5. Pajisjet mjekësore, të cilat janë të destinuara për përdorim nga profesionistët shëndetësorë, reklamohen ekskluzivisht vetëm nga këta të

fundit. Në kuptim të këtij vendimi, profesionistët shëndetësorë janë mjekët, dentistët, veterinerët, farmacistët, dietologët klinicistë, teknikët e shkencave mjekësore, asistentë të kujdesit social dhe shëndetësor, profesionistët në fusha mjekësore të ngjashme ose studentët që ndjekin studimet në këto fusha.

6. Pajisjet mjekësore mund të promovohen vetëm në lidhje me qëllimin e tyre të synuar, të deklaruar nga prodhuesi.

7. Publiciteti bëhet vetëm nga prodhuesit e pajisjeve mjekësore, përfaqësuesit e prodhuesve të huaj, që kanë të regjistruar aktivitetin në Republikën e Shqipërisë, tregtuesit me shumicë të pajisjeve mjekësore.

8. Publiciteti i pajisjeve mjekësore nuk duhet të bëhet në mënyrë inkurajuese për konsum, si mallrat e përgjithshme të konsumit, por duhet të bazohet në informacione profesionale.

9. Publiciteti i pajisjeve mjekësore duhet të sigurojë informacion të mjaftueshëm, duke përfshirë të gjitha elementet e nevojshme si përfitimet, rreziqet e trajtimit, çmimet, rimbursimi.

10. Nëse publiciteti përfshin një krahasim të pajisjeve mjekësore, duhet të jetë e qartë se cilat pajisje mjekësore po krahasohen. Krahasimet duhet të bëhen vetëm për pajisjet që mbulojnë produktet me të njëjtin qëllim përdorimi dhe kur krahasohen një ose më shumë karakteristika të rëndësishme, të verifikueshme dhe përfaqësuese të pajisjeve mjekësore, në të cilat mund të përfshihet çmimi.

11. Pajisjet mjekësore me porosi, të destinuara ekskluzivisht për t'u përdorur nga profesionistët e shëndetit, në lidhje me trajtimin e pacientëve të ndryshëm, nuk mund të reklamohen.

12. Pajisjet mjekësore nuk duhet të tregojnë ndonjë shenjë që mund të jetë keqinformuese/ mashtruese, referuar qëllimit të synuar të përdorimit të pajisjes dhe as të jenë në ndonjë mënyrë, në konflikt me markimin CE ose certifikimin FDA ose të zvogëlojnë dukjen dhe lexueshmërinë e tyre.

13. Në publicitetin e pajisjeve mjekësore ndalohet çdo informacion, që:

a) përshkruan funksione dhe veçanti, të cilat pajisja realisht nuk i ka;

b) krijon një përshtypje false lidhur me trajtimin, diagnozën, funksionet ose veçoritë, të cilat pajisja nuk i ka;

c) dështon në informimin e përdoruesit ose të pacientit për një rrezik të mundshëm, që lidhet me përdorimin e pajisjes, sipas indikacionit që pajisja ka;

ç) sugjeron përdorime të pajisjes, të ndryshme nga ato që ajo ka, për të cilat është marrë vlerësimi i konformitetit dhe që i shërbejnë qëllimit të pajisjes;

d) ofron dhurata apo konkurse ose çmime që lidhen me promovimin e pajisjeve mjekësore drejtuar pacientëve dhe përdoruesve;

dh) krijon përshtypjen se është i panevojshëm konsultimi me profesionistë shëndetësorë, nëse trajtimi ose diagnoza nga një person i tillë është i nevojshëm;

e) krijon përshtypjen se përdorimi i pajisjes mjekësore është pa rrezik;

ë) u drejtohet ekskluzivisht ose kryesisht fëmijëve;

f) është i tillë që mund të çojë në vetëdiagnozë të gabuar ose përdorim në terma të ekzagjeruar, alarmues ose mashtrues, imazhe, ilustrime etj. të ndryshimeve në trupin e njeriut;

g) krijon përshtypjen se një pajisje mjekësore mund të garantojë rimëkëmbjen nga sëmundja dhe se shëndeti i subjektit mund të përmirësohet vetëm duke përdorur pajisjen mjekësore të reklamuar, ndërkohë gjykimi objektiv duhet të jepet me dëshmi;

gj) sugjeron se shëndeti i subjektit mund të ndikohet nga mospërdorimi i pajisjes mjekësore që është reklamuar;

h) inkurajon pacientët të heqin dorë nga procedurat e trajtimit të pranuara përgjithësisht;

i) krijon konfuzion nga përdorimi i termave shkencorë të panjohur për publikun e gjerë për kushtet e zakonshme shëndetësore;

j) i referohet një rekomandimi nga shkencëtarë, profesionistët e shëndetësisë ose personat, të cilët nuk janë të lartpërmendur, por që, për shkak të statusit të tyre si personalitete të njohura, mund të inkurajojnë përdorimin e pajisjes mjekësore;

k) cenon ose abuzon me dinjitetin njerëzor.

14. Monitorimi për ruajtjen e vërtetësisë dhe sigurisë së publicitetit të pajisjes mjekësore kryhet nga struktura përgjegjëse për pajisjet mjekësore pranë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.

15. Shkelja e rregullave të publicitetit, të përcaktuara në këtë vendim, përbën kundërvajtje

administrative dhe dënohet nga inspektorët e pajisjeve mjekësore, sipas legjislacionit në fuqi.

16. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe subjektet, që tregtojnë pajisje mjekësore në Republikën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

VENDIM
Nr. 480, datë 13.7.2022

PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË GRANTEVE PËR *STARTUP*-ET DHE LEHTËSUESIT E *STARTUP*-EVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14, pika 7, të ligjit nr. 25/2022, "Për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve", me propozimin e ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies së granteve për *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve, të përzgjedhur nga Komisioni i Vlerësimit, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

SHTOJCA 1

FITUESIT *STARTUP*

Nr.	Emri i fituesit	Individ/Person Fizik/ person juridik	Numri i identifikimit/NIPT	Numri i pasaportës *start-up*	Vlera e financimit të miratuar (në lek)
1	MELIHA ZYBERAJ	Person fizik	L96818007S	S0106	2,145,280
2	DIGITSAPIENS sh.p.k.	Person juridik	M01628007V	S0245	4,000,000
3	INOTECALBANIA sh.p.k.	Person juridik	L93730403P	S0711	3,749,400
4	SKAITECH sh.p.k.	Person juridik	M02209004H	S0153	4,925,000
5	KAMELA HASKO	Person fizik	M11305001L	S0611	5,000,000
6	LEKO TECH sh.p.k.	Person juridik	L82107028B	S0210	2,793,168
7	LIST ALBANIA sh.p.k.	Person juridik	M21731013Q	S0511	2,927,200
8	XHULIA KURTI	Individ	K15223052J	S0188	3,888,000
9	3 D SKAI sh.p.k.	Person juridik	M21727023D	S0417	2,952,857
10	SPONTAN CREATIVE MEDIA sh.p.k.	Person juridik	L82322017V	S0208	4,990,000
11	XOEN sh.p.k.	Person juridik	L91910502H	S0089	5,000,000
12	TERENC PEPA	Individ	I71008081G	S0789	1,154,000
13	AKADEMIA E DRONEVE DHE SISTEMEVE UAS – ALBADRON sh.p.k.	Person juridik	M11328007N	S0461	5,000,000
14	LACONICS sh.p.k.	Person juridik	M02325002F	S0149	5,000,000
15	CUT-CLO sh.p.k.	Person juridik	M21801034G	S0778	2,999,200
16	ERI KOKALARI	Person fizik	L72230015S	S0610	4,625,000
17	CITRUS GROUP sh.p.k.	Person juridik	L77220205G	S0746	4,650,000
18	E-AUDIOSAFETY-ALBANIA sh.p.k.	Person juridik	M21704036L	S0339	2,997,600
19	HMS sh.p.k.	Person juridik	M01819013D	S0203	4,580,000
20	ESIG.AL sh.p.k.	Person juridik	L81420010C	S0326	2,622,070
21	XHOANA KRISTO	Individ	J55816078L	S0046	1,185,000
22	A.L.S CONSULTING sh.p.k.	Person juridik	M02403019H	S0509	3,317,600
23	VALUE PROVIDER sh.p.k.	Person juridik	M12406047F	L0036 (*startup* me pasaportë lehtësuesi)	2,520,000

FITUESIT LEHTËSUES TË *STARTUP*-EVE

Nr.	Emri i fituesit	OJF/ person fizik/ person juridik/ent publik	NIPT	Numri i pasaportës lehtësues	Vlera e financimit të miratuar (në lek)
1	BARLETI GROUP sh.p.k.	Person juridik	K52115006H	L0046	7,000,000
2	BASHKIA KORÇË	Ent publik	K54105075C	L0108	19,999,008
3	AULEDA	OJF	K56524212N	L0028	1,000,000
4	BASHKIA DIMAL	Ent publik	K52917023I	L0080	8,000,000
5	BASHKIA BULQIZË	Ent publik	K46915401W	L0172	2,321,549
6	BASHKIA PUKË	Ent publik	K58811318P	L0170	2,458,000
7	JUNIOR ACHIEVEMENT OF ALBANIA	OJF	L31311451J	L0203	5,880,947
8	PAMELA GRUDA	Person fizik	M12109030R	L0208	4,000,000

9	BASHKIA SHKODËR	Ent publik	K36813001H	L0142	7,000,000
10	BASHKIA MALËSI E MADHE	Ent publik	K48420701I	L0094	15,369,369
11	LIFE sh.p.k.	Person juridik	L41629010D	L0175	3,000,000
12	TIRANA BUSINESS UNIVERSITY sh.p.k.	Person juridik	L01801024T	L0096	3,000,000
13	BLERI DERVISHI	Person fizik	L91904024A	L0115	9,977,600
14	BASHKIA ROSKOVEC	Ent publik	K52905407N	L0194	3,000,000
15	ALBANA MUÇAJ	Person fizik	L61712031O	L0131	3,000,000
16	UNIQUE JUNIOR ENTERPRISE	OJF	L31724451R	L0136	2,000,000
17	FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS, UNIVERSITETI I TIRANËS	Ent publik	K51713059D	L0235	9,184,200
18	QENDRA BALANCE	OJF	M11315451H	L0051	9,800,000
19	QENDRA METAVERSE	OJF	M21509456N	L0193	5,000,000
20	SHKOLLA TEKNIKE ELEKTRIKE	Ent publik	K51717012I	L0030	5,215,200
21	UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS	Ent publik	J61915028N	L0098	5,000,000
22	ICTS MEDIA sh.p.k.	Person juridik	L21624006R	L0114	9,711,200
23	KOESTINGER & PARTNERS - INNOVATION SUSTAINABILITY sh.p.k.	Person juridik	M21402059H	L0068	5,000,000
24	QENDRA PROTIK	OJF	L22010451T	L0020	3,000,000
25	SHOQATA KS FACTOR	OJF	M01502451T	L0087	4,000,000
26	NEW MEDIA DIGITAL sh.p.k.	Person juridik	L71705007H	L0054	3,000,000
27	FONDACIONI DRITAN HOXHA	OJF	L11321451L	L0097	8,000,000
28	QENDRA KËRKIMORE PËR RRITJE EKONOMIKE DHE QEVERISJE	OJF	M12323451D	L0055	5,000,000
29	DESTIL CREATIVE HUB	OJF	M21418452F	L0110	9,000,000

VENDIM
Nr. 482, datë 13.7.2022

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE, ME SHKËMBIM LETRASH, TË MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE *ARTIGIANCASSA S.P.A.*, PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT TË NDIHMËS SË INTEGRUAR PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME SHQIPTARE, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 147/2013

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 23, të ligjit nr. 43/2016, "Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese, me shkëmbim letrash, të marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe *Artigiancassa S.P.A.,* për financimin e programit të ndihmës së integruar për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme shqiptare, ratifikuar me ligjin nr. 147/2013, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

Shkëlqesisë së Saj, znj. Delina Ibrahimaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë
Qeveria e Republikës së Shqipërisë

Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj
Drejtoria e Koordinimit dhe Ofrimit të Ndihmës së Huaj Sektori i Marrëveshjeve dhe Ofrimit të Ndihmës së Huaj
Dëshmorët e Kombit nr. 3, Tiranë, Shqipëri

Për dijeni: Me postë elektronike të regjistruar
Ministrisë Italiane për Punët e Jashtme, Zyra V DGCS
Agjencisë Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor
Romë, 17.3.2022

Lënda: **Marrëveshje Financiare F.ROT 11/006/00, me vlerë 15,000,000.00 euro ndërmjet Këshillit të Ministrave të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Artigiancassa S.P.A. (të zëvendësuar nga Cassa Depositi e Prestiti S.P.A.) – Program në favor të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Shqipëri**

Duke iu referuar shkresës suaj me numër protokolli 421, datë 12.1.2022.

E nderuar Zonjë,

Duke iu referuar Marrëveshjes Financiare të lartpërmendur dhe në vijim të kërkesës suaj të datës 12.1.2022, ju informojmë se:

- periudha e disbursimit të kredisë së butë do të zgjatet deri në datën 31 dhjetor 2022, pa cenuar sekuestrimin e fondeve që pritet të disbursohen deri në dhënien e vendimit nga ana e gjykatësit;
- pas marrjes së raportit, siç parashikohet në nenin 9.6, nga Ministria juaj e nderuar që vërteton përdorimin e fondeve të disbursuara, duke filluar nga dita e sotme, do të adresojmë dhe do t'ju komunikojmë shtyrjen e periudhës së disbursimit për asistencë teknike deri në datën 31 tetor 2022.

Me respekt,

(nënshkrimi)
Lisbi C. Valdez
Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.
Kreu i Fondit të Disponueshëm për Bashkëpunim Zhvillimor

Cassa Depositi e Prestiti
Investiamo nel domani

Cassa Depositi e Prestiti
Societa per Azioni
Via Goito, 4 -00185 Roma
T +39 06 4221 1
F +39 06 4221 4026

Capitale Sociale
€ 4.051.143.264,00 i.v.
Iscritta preso
CCIAA di Roma al
n.REA 1053767

Codice Fiscale
e iscrizione al Registro
delle Imprese di Roma
80199230584
Partita IVA 07756511007

00185 – Romë, Itali

Bashkëpunimi Ndërkombëtar: fondorotativocs@cdp.it

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Drejtoria e Huamarrjes, Divizioni i Marrëveshjeve Departamenti i Përgjithshëm i Borxhit Publik
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
TIRANË, SHQIPËRI
k.a. z. Gavril Lasku – Drejtor

Për dijeni të:
MINISTRISË ITALIANE PËR PUNËT E JASHTME DHE ZYRËS V DGCS PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR
AGJENCISË ITALIANE PËR BASHKËPUNIM ZHVILLIMOR – ROMË
AGJENCISË ITALIANE PËR BASHKËPUNIM ZHVILLIMOR – TIRANË
Romë, 16.5.2022

Lënda: **Marrëveshje Financiare me një vlerë prej 15,000,000.00 eurosh ndërmjet *Artigiancassa S.p.A.* dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë F.ROT/AID 11/006/00**

Të nderuar zotërinj,

Duke iu referuar shkresës suaj me nr. prot. 25, të datës 18.3.2022, nëpërmjet këtij dokumenti dëshirojmë t'ju informojmë se pas marrjes së raporteve të auditimit dhe rishikimit të përbashkët të kryer nga AICS-ja në Romë dhe CDP-ja, duke marrë parasysh ngjarjet e ndryshme që kanë ndikuar në përdorimin e fondeve të disbursuara, nuk ka asnjë kundërshtim për zgjatjen e afatit të përdorimit të fondeve tashmë të disbursuara deri në datën 31 mars 2023 për kuotën e kredisë koncesionare, që synon financimin e linjës së kredisë për NVM-të dhe asistencën teknike.

Cassa Depositi e Prestiti
Investiamo nel domani

Cassa Depositi e Prestiti
Societa per Azioni
Via Goito, 4 -00185 Roma
T +39 06 4221 1
F +39 06 4221 4026

Capitale Sociale
€ 4.051.143.264,00 i.v.
Iscritta preso
CCIAA di Roma al
n.REA 1053767

Codice Fiscale
e iscrizione al Registro
delle Imprese di Roma
80199230584
Partita IVA 07756511007

00185 – Romë, Itali

Në pritje të marrjes së raportit të përditësuar të auditimit: i. kur të përdoren në mënyrë të plotë fondet; ose ii. kur të skadojë afati i lartpërmendur.

Me respekt,nënshkruar elektronikisht nga Lisbi Valdez

Datë 16.5.2022, 14:52:02

Lisbi C. Valdez
Cassa Depositi e Prestiti S.p.A.
Fondi i Disponueshëm për Bashkëpunim Zhvillimor

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 240/1, datë 4.7.2022

PËR CAKTIMIN E TARIFAVE PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT TË TREGTIMIT TË BARNAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 11, pika 6, të ligjit nr. 105/2014, "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar; dhe të VKM-së nr. 299, datë 8.4.2015, "Për miratimin e rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJMË:

1. Caktimin e tarifave të autorizimit për tregtim, si më poshtë vijon:

a) për çdo formëdozë bari tarifa është 800 euro;

b) për barnat në terapinë antitumorale tarifa është 500 euro;

c) për barnat homeopatike që pajisjen me autorizim për tregtim me procedurë të thjeshtuar tarifa është 150 euro;

d) për barnat homeopatike, që pajisjen me autorizim për tregtim tarifa është 300 euro.

2. Pagesa e tarifës për aplikim për autorizim të barit e përcaktuar në pikën 1 të këtij urdhri kryhet nga prodhuesit vendës të licencuar, mbajtësit e autorizimit për tregtim ose nga përfaqësuesit ligjor të autorizuar prej tyre, në llogarinë bankare të të ardhurave të Degës së Thesarit Tiranë, për llogari të AKBPM-së, e cila plotëson dokumentin "Faturë për arkëtim", që paguesi i tarifës paraqet në bankën e nivelit të dytë. Mënyra e kryerjes së pagesës është, si vijon: Një pjesë e tarifës prej 100 eurosh paguhet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit përkatës, pas plotësimit të formularit të aplikimit dhe pjesa e mbetur e tarifës jo më vonë se 45 ditë nga data e miratimit të autorizimit për tregtim.

3. Caktimi i tarifës për autorizim të kushtëzuar është 800 euro. Pagesa e tarifës kryhet jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga data e miratimit nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

4. Caktimi i tarifës për Rinovimin e Autorizimit për Tregtim për çdo formëdozë bari, që pajiset me riautorizimin për tregtim, është 350 euro. Për barnat homeopatike për rinovimin e autorizimit për tregtim tarifa është 150 euro.

5. Pagesa e tarifës për caktimin për riautorizim të barit bëhet e plotë në momentin e dorëzimit të dokumentacionit përkatës. Nëse aplikanti

dorëzon dosjen për riautorizim tregtimi 90 ditë para afatit të përfundimit të autorizimit për tregtim do të aplikohet një kamatëvonesë 1.5% e tarifës fillestare për çdo ditë vonesë.

6. Caktimi i tarifave për variacionet që pëson bari gjatë periudhës së autorizimit për tregtim kryhet e plotë në momentin e dorëzimit të dokumentacionit përkatës dhe është, si më poshtë vijon:

a) Variacion tipi 1 – tarifa që aplikohet është 50 euro;

b) Variacion tipi 2 – tarifa që aplikohet është 100 euro.

7. Pagesa e tarifave, sipas përcaktimeve të këtij urdhri kryhet në monedhën euro ose në lekë, të konvertuar sipas kursit të këmbimit valuator në ditën e kryerjes së pagesës, nga prodhuesit vendës të licencuar, mbajtësit e autorizimit për tregtim ose nga përfaqësuesit ligjorë të autorizuar prej tyre, në llogarinë bankare të të ardhurave të Degës së Thesarit Tiranë, për llogari të AKBPM-së, e cila plotëson dokumentin "Faturë për arkëtim", që paguesi i tarifës paraqet në bankën e nivelit të dytë.

8. Të ardhurat nga tarifat derdhen 100% në Buxhetin e Shtetit.

9. Përjashtohen nga tarifat, sipas përcaktimeve në këtë urdhër:

a) barnat e përcaktuara si barna jetime;

b) institucionet shëndetësore publike, që janë përfaqësues ligjorë të mbajtësit të autorizimit për tregtim dhe pajisen me autorizim tregtimi të kushtëzuar, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

11. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Delina Ibrahimaj

VENDIM
Nr. 31, datë 6.7.2022

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN NGA OTP BANK NYRT (HUNGARI) TË 100 PËR QIND TË KAPITALIT AKSIONAR TË BANKËS ALPHA ALBANIA SHA

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e", të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të shkronjës "gj", të pikës 1, të nenit 24, si dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për zotërimin e 100 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Alpha Albania sh.a. nga OTP Bank Nyrt (Hungari).

2. Ngarkohet Banka Alpha Albania sh.a. të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përmbushjen e transaksionit të kalimit të aksioneve.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 33, datë 6.7.2022

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN "PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT QENDROR TË REGJISTRIMIT DHE SHLYERJES SË TITUJVE (AFISaR)"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (AFISaR)", miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 76, datë 18.12.2014, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 16, pika 2, shkronja "a" shfuqizohet.

b) Në nenin 20 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 3, shkronja "b" ndryshon me përmbajtje si vijon:

"të ketë nënshkruar kontratën tip të pjesëmarrjes së tërthortë të personave juridikë, sipas shtojcës 2, kur llogaria e titullit hapet nga Banka e Shqipërisë ose të ketë lidhur kontratë kujdestarie me një pjesëmarrës tjetër të drejtpërdrejtë.";

ii. pika 4 shfuqizohet.

c) Në nenin 26, pika 2, shkronja "b" ndryshon me përmbajtje si vijon:

"*llogaria omnibus (1), që është llogaria e hapur në emër të pjesëmarrësit dhe ku depozitohen titujt e zotëruar nga klientët e pjesëmarrësit. Llogaritë omnibus kategorizohen sipas natyrës së klientit, sipas përcaktimit në shtojcën 21.*".

d) Në nenin 28, pas pikës 3, shtohet pika 3/1 me përmbajtje si vijon:

"*3/1. Dita e regjistrimit për ngjarjet e pagesave është:*

a) 1 (një) ditë pune përpara datës së pagesës në monedhën vendëse;

b) 3 (tri) ditë pune përpara datës së pagesës në monedhën e huaj".

e) Në nenin 50 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 3, fjalia e parë riformulohet me përmbajtje si vijon:

"Ministria përkatëse për financat përjashtohet nga komisionet.".

ii. Pika 5/1 ndryshon me përmbajtje si vijon:

"Komisionet për:

a) operacionet e veçanta, shlyhen në bazë ditore, në ditën e nesërme të punës;

b) pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë, sipas pikës 4, shlyhen automatikisht brenda tremujorit të parë të vitit ose të anëtarësimit;

c) pjesëmarrësit e tërthortë, sipas pikës 4, shlyhen pas njoftimit të administratorit, brenda tremujorit të parë të vitit ose të anëtarësimit.

Administratori mund t'u dërgojë pjesëmarrësve në ditën e parë të punës të muajit kalendarik, një faturë përmbledhëse për komisionet e paguara në muajin paraardhës.".

f) Në shtojcën 1, neni 7, shkronja "b" ndryshon me përmbajtje si vijon:

"Llogari omnibus, sipas përzgjedhjes nga lista e shtojcës 21 të rregullores. Lista e llogarive omnibus është pjesë integrale e kontratës dhe mund të ndryshojë pas njoftimit me shkresë nga përfaqësuesi i pjesëmarrësit në këtë kontratë dhe konfirmimit nga përfaqësuesi i administratorit.".

g) Shtojcat 3 dhe 4 shfuqizohen.

h) Në shtojcën 6, pika 2, shkronja "b", ndryshon sipas përmbajtjes së aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

i) Në shtojcën 7, pas tabelës shtohet paragrafi me përmbajtje si vijon:

"Në ditën e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar, sipas përcaktimeve në rregulloren "Për minimumin e rezervës së detyruar mbajtur nga bankat pranë Bankës së Shqipërisë", DVP cut-off kryhet në orën 16:15.".

j) Shtojca 8 ndryshon sipas përmbajtjes së aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

k) Në shtojcën 11, paragrafi II shfuqizohet.

l) Pas shtojcës 20, shtohet shtojca 21, sipas përmbajtjes së aneksit bashkëlidhur këtij vendimi.

m) Emërtimi "Ministria e Financave" zëvendësohet në të gjithë tekstin e rregullores me emërtimin "*ministria përkatëse për financat*".

2. Në pikën 1, shkronjat "a", "b", nënpika "ii", "e", nënpika "i", "g" dhe "k" të këtij vendimi, hyjnë në fuqi më 1 janar 2023.

3. Të gjitha shkronjat përbërëse të pikës 1, përveç atyre të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, hyjnë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë ditë) pas publikimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

4. Pjesëmarrësit e sistemit AFISaR, për zbatimin e pikës 1, shkronja "c" të këtij vendimi, duhet të kryejnë veprimet brenda 1 (një) muaji nga hyrja në fuqi e ndryshimeve sipas pikës 3 të tij. Kostot e këtyre veprimeve do të rimbursohen nga administratori i sistemit AFISaR.

5. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe pjesëmarrësit e sistemit AFISaR.

6. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me botimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

ANEKS

Shkronja "b" e pikës 2 të shtojcës 6
Mesazhet njoftuese

Tipi i mesazhit	*Përshkrimi*
MT 599	*Mesazh përshkrues*
MT 548	*- Njoftimi për përputhjen e instruksioneve (gjenerohet automatikisht nga sistemi, por mund të zgjidhet edhe mosmarrja e këtij mesazhi).* *- Njoftimi për refuzimin e instruksionit ku përfshihet edhe arsyeja e refuzimit.*
MT535	*- Njoftim për gjendjen e titujve në llogarinë e mbajtësit.*
MT564	*- Njoftim për ngjarjet e pagesave.*
MT566	*- Konfirmim për ngjarjen e pagesave.*

SHTOJCA 8
KOMISIONET E APLIKUARA NË SISTEMIN AFISaR

Lloji i komisioneve	**Në vlerë (lek)**	**Në përqindje**
A. Komision për anëtarësim dhe mirëmbajtje		
Komision hyrjeje (anëtarësimi) për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë	250,000	
Komision hyrjeje (anëtarësimi) për pjesëmarrësit e tërthortë	0 (zero)	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për çdo llogari për pjesëmarrësit e tërthortë (persona juridikë) me llogari titulli në Bankën e Shqipërisë	250,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë për çdo llogari omnibus të kategorive A, B, C dhe D	250,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë për çdo llogari omnibus të kategorive E, F, G, H, I	a) 0 (zero) në qoftë se pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë zotëron llogari omnibus të kategorive A, B, C, D b) 250,000 në rast se pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë nuk zotëron asnjë llogari omnibus të kategorive A, B, C, D	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për bursën e titujve	100,000	
Komision vjetor mirëmbajtjeje për pjesëmarrësit e tërthortë me llogari titulli në pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë përveç Bankës së Shqipërisë*	150,000	
Komision daljeje	0 (zero)	
B. Komision për operacionet e veçanta		
Komision (1) procesimi për operacionet DVP (shitje/blerjet, kredi brenda ditës me Bankën e Shqipërisë dhe transaksioni i kthimit,	350	

marrëveshje riblerjeje/të anasjella riblerjeje me Bankën e Shqipërisë dhe transaksioni i anasjelltë)		
Komision (2) procesimi për operacionet DVP (marrëveshje riblerjeje/të anasjella riblerjeje dhe transaksioni i anasjelltë të ndryshme nga ato me Bankën e Shqipërisë)	200	
Komision procesimi për operacionet FOP (transfertat e portofolit, transaksionet midis llogarisë vetjake të pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë dhe llogarisë së një pjesëmarrësit të tërthortë, që është klient i të njëjtit pjesëmarrës së drejtpërdrejtë, transaksionet midis dy pjesëmarrësve që kanë të njëjtin agjent shlyerës në AIPS, ekzekutimi i kolateralit, zëvendësimi i titullit në një marrëveshje riblerjeje, transaksionet për të plotësuar kërkesën për marzhin e ruajtjes së vlerës së titullit të tregtuar nëpërmjet marrëveshjeve të riblerjes)	350	
Komision për procesimin e rezultateve të tregut primar (emetim, maturim, ankand rihapjeje, ankand për blerjen mbrapsht të titullit)	200	
Komision për operacionet e netimit, sipas modelit DVP2 për transaksionet e tregut primar	150	
Komision për procesimin e pagesës së interesave të përfituar nga investimi në tituj	1200	
Komision për procesimin e marrëveshjeve të kolateralit financiar (regjistrimi i kolateralit, lirimi i kolateralit)	350	
Komision për kthimin e kuponave nga rishitësi tek riblerësi në një marrëveshjeje *repo/reverse repo*	350	
Komision për riciklimin e transaksioneve të tregut primar	0 (zero)	
Komision për procesimin e operacioneve që rrjedhin nga thirrja e titujve, nga ankandet e marrëveshjeve të riblerjes/të anasjella riblerjeje të ministrisë përkatëse për financat, nga taksimi i titujve	0 (zero)	
C. Komisione të tjera		
Përgatitja e raporteve sipas kërkesës specifike	Për t'u vlerësuar në bazë të kërkesës specifike	
Komisione për trajnimin e operatorëve të sistemit	0 (zero)	
Komision për certifikimin e operatorëve të sistemit	0 (zero)	
Komision për pajisjen e aksesit në sistemin AFISaR	3 (tre) për pjesëmarrës falas, të tjerat me pagesë sipas kostos së pajisjes Për institucionet/organet pajisja është me pagesë	
Komision për kërkimin e informacionit nga institucioni/organi	0 (zero)	

* Ky komision i faturohet dhe mblidhet nga pjesëmarrësi i drejtpërdrejtë dhe më pas i transferohet Bankës së Shqipërisë.

SHTOJCA 21
KATEGORITË E LLOGARIVE OMNIBUS

Kategoria		**Identifikimi i omnibusit bazë**	**Lloji i investitorit që do përfshihet në omnibus**
A	Person fizik (individë)	0001ii	Do të depozitohen titujt në pronësi të personave fizikë (rezident dhe jorezident)
B	Biznes i regjistruar jofinanciar	0001rb	Do të depozitohen titujt në pronësi të kompanive me aktivitet jofinanciar
C	Fonde pensioni	0001pf	Do të depozitohen titujt në pronësi të fondeve të pensionit vullnetar
D	Biznes i regjistruar jorezident	0001nr	Do të depozitohen titujt në pronësi të kompanive (financiare dhe jofinanciare) që nuk janë rezidentë
E	Ndërmjetës financiarë	0001fa	Do të depozitohen titujt në pronësi vetjake të institucioneve financiare jobanka dhe shoqërive komisionere rezidente, që kryejnë ndërmjetësim në tregun e kapitaleve
F	Fonde investimi	0001if	Do të depozitohen titujt në pronësi të klientëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive
G	Shoqëritë e sigurimit	0001ic	Do të depozitohen titujt në pronësi të shoqërive të sigurimit, shoqërive të risigurimit dhe të ndërmjetësve në sigurime
H	Klientë të ndërmjetësve financiarë	0001bs	Do të depozitohen titujt në pronësi të klientëve të ndërmjetësve financiarë
I	Shoqata fondacione	0001np	Do të depozitohen titujt në pronësi të shoqatave, fondacioneve, OJF-ve e të tjerave me natyrë të ngjashme

VENDIM
Nr. 34, datë 6.7.2022

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR RRITJEN E PËRQINDJES SË PJESËMARRJES INFLUENCUESE TË AKSIONARIT "EUROSIG" SHA NË KAPITALIN E BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË SHA

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e", të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të shkronjës "h", të pikës 1, të nenit 24, dhe nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për rritjen e përqindjes së pjesëmarrjes influencuese nga 21.02 për qind në 51.017 për qind të aksioneve, me të drejtë vote të aksionarit "EUROSIG" sh.a. në kapitalit aksionar të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., me kushtin që brenda datës 31.12.2022:

a) Aksionari "EUROSIG" sh.a. të kontribuojë me mjete likuide në kapitalin e Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., në shumën 3 milionë euro;

b) Aksionari i tërthortë "EURO-ALBA-EA" sh.p.k. të sistemojë situatën me detyrimet tatimore.

2. Ngarkohet Banka e Bashkuar e Shqipërisë të njoftojë Bankën e Shqipërisë për plotësimin e kushteve të mësipërme.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për botimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 105
Datë: 2022/07/15 14:10:15
04528adb-3538-4e08-b823-81220c414624

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë